



NË KËTË NUMËR:

<i>Kolegji "Pjetër Budi" me ofertë speciale për studime</i>	2
<i>Kolegji "Pjetër Budi" anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Universiteteve të Doganave</i>	3
<i>Është lansuar web faqja e re e Kolegjit "Pjetër Budi"</i>	4
<i>Hulumtim: Prishtinasit preferojnë Kombëtaren e Spanjës, Barcelonën dhe Messinë</i>	5
<i>Hulumtim: Meshkujt pëlqejnë Golf'in, femrat Mercedes'in</i>	6
<i>Hulumtim: Si jetojnë asbkalinjët e Podujevës?</i>	7
<i>Hulumtim: Sa shpenzojnë kompanitë për marketing?</i>	8
<i>dhe të tjera...</i>	

Kolegji “Pjetër Budi” me ofertë speciale për studime

Përveç programeve studimore unike në Kosovë, Kolegji “Pjetër Budi” ka ofertë të veçantë për studime, në të gjitha drejtimet dhe në të dy nivelet - Bachelor dhe Master.

Kështu, për regjistrim në studimet Bachelor, studentët e shkëlqyeshëm përfitojnë 20 % zbritje, për grupe deri në veta – 5 % zbritje (BA dhe MA), për grupe deri në dhjetë veta – 10 % zbritje (BA dhe MA), për dy pjesëtarët të një familjeje – 10 % zbritje (BA dhe MA), për pjesëtarët e Policisë së Kosovës (për studime në departamentin Polici Financiare) – 20 % zbritje (BA dhe MA), për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe të Doganës së Kosovës 20 % zbritje (BA dhe MA), si dhe për studentët e “Pjetër Budit deri 20 % zbritje (MA).

Kolegji “Pjetër Budi” ofron edhe lehtësira të tjera, siç është mundësia e pagesës për studime deri në 12 këste.

Kolegji “Pjetër Budi” ofron studime universitare në drejtime zhvillimore, siç janë Doganë dhe Shpedicion, Sigurime, Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë, Sigurime, Administrim Biznesi, Menaxhim i Resurseve Njerëzore, Administratë Publike, Banka-Kontroll Financiar (Polici Financiare) dhe Menaxhim i Marketingut (në nivelin Bachelor), si dhe Menaxhment, Menaxhim i Turizmit e Hotelerisë, Menaxhim i Sigurimeve dhe Doganë e Shpedicion (në nivelin Master) .



Kolegji “Pjetër Budi” ofron studime universitare në drejtime zhvillimore, siç janë Doganë dhe Shpedicion, Sigurime, Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë, Sigurime, Administrim Biznesi, Menaxhim i Resurseve Njerëzore, Administratë Publike, Banka-Kontroll Financiar (Polici Financiare) dhe Menaxhim i Marketingut (në nivelin Bachelor), si dhe Menaxhment, Menaxhim i Turizmit e Hotelerisë, Menaxhim i Sigurimeve dhe Doganë e Shpedicion (në nivelin Master) .

Konkursi për regjistrimin e studentëve në vitin akademik 2013/2014 vazhdon të jetë i hapur.



“Pjetër Budi” anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Universiteteve të Doganave



Kolegji “Pjetër Budi”, Prishtinë, tashmë është anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Universiteteve të Doganave (International Network of Customs Universities), anëtarë të të cilit janë rreth 200 universitete nga mbarë bota. Pjesë e këtij rrjeti të rëndësishëm akademik botëror janë universitete nga vendet e Bashkimit Evropian, SHBA-së, Kanadasë, Amerikës Latine, Australisë, Afrikës, Japonisë dhe vendeve tjera nga Azia.

Prej universiteteve dhe institucioneve të vendeve të Bashkimit Evropian, anëtarë janë universitete të njohura, si ai i Muensterit të Gjermanisë, Qendra për Studime dhe Hulumtime Zhvillimore Ndërkombëtare e Universitetit Auvergne në Francë, Akademia Gjermane për Tregti të Jashtme dhe Transport në Bremen të Gjermanisë, Universiteti i Notingemit për Biznes dhe Menaxhment në Notingem të Anglisë, Universiteti i Veronës në Verona të Italisë etj.

Kolegji “Pjetër Budi” ka bashkëpunim të ngushtë me këto institucione të arsimit të lartë që ofrojnë studime në fushën e doganës dhe shpeditoni. Gjithashtu, Kolegji “Pjetër Budi” rregullisht merr pjesë në takimet dhe konferencat shkencore që organizohen nga kjo organizatë prestigjioze botërore.

Në linkun në vazhdim mund të shihni se Kolegji “Pjetër Budi” është anëtar i këtij rrjeti ndërkombëtar: <http://incu.org/cgi-bin/allegro.pl?directory>.

Është lansuar web faqja e re e Kolegjit “Pjetër Budi”



Është lansuar faqja e re në internet e Kolegjit “Pjetër Budi”. Web faqja e këtij institucioni të arsimit të lartë përmban të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me këtë institucion, i cili ofron studime universitare në fusha specifike në Kosovë dhe rajon.

Kolegjit “Pjetër Budi” ofron studime universitare në këto drejtime: Doganë dhe Shpeditcion, Menaxhim i Turizmit dhe Hotelarisë, Sigurime dhe Administrim Biznesi.

Për më shumë shumë, klikoni në

www.pjeterbudi.com

Studentët e Kolegjit “Pjetër Budi” realizojnë dy hulumtime

Një grup studentësh të Kolegjit “Pjetër Budi” kanë filluar realizimin e dy hulumtimeve në terren. I pari ka të bëjë me kënaqshmërinë e qytetarëve dhe bizneseve me shërbimet bankare. Ndërkaq, hulumtimi i dytë përfshin qytetarët kosovarë të ardhur nga diaspora. Ata do të anketohen lidhur me problemet me të cilat ballafaqohen gjatë qëndrimit në Kosovë dhe për shpenzimet që i bëjnë brenda vitit për të ndihmuar familjarët e tyre në vendlindje.

Hulumtimet pritet të përfundojnë brenda dy javësh, ndërkaq rezultatet do të publikohen më vonë.

Hulumtimet janë pjesë përbërëse e rëndësishme e programeve studimore të Kolegjit “Pjetër Budi” dhe e punës praktike të studentëve.





Hulumtim: Prishtinasit preferojnë Kombëtaren e Spanjës, Barcelonën dhe Messinë

Shumicës së qytetarëve të kryeqytetit të Kosovës iu pëlqen futbolla, ndërkaq kur është fjala për të preferuarit e tyre, Kombëtarja e Spanjës, ekipi i Barcelonës dhe futbollisti Lionel Messi janë në krye të listave.

Hulumtimi është realizuar në Prishtinë nga studentët e Kolegjit “Pjetër Budi”, në kuadër të punës hulumtuese-shkencore, me pjesëmarrjen e 68 për qind të respondentëve meshkuj dhe 32 për qind femra, nga mosha 16 deri 56 vjeç.

Futbollin e përcjellin 72 për qind të të anketuarve, të cilët kanë parapëlqyer të përmendin tetë kombëtare futbolla, në pyetjen se cila është kombëtarja e tyre e preferuar.

31 për qind e qytetarëve pëlqejnë Kombëtaren e Spanjës, 19 për qind atë të Anglisë, 12 për qind Italinë, 10 për qind Gjermaninë - aq sa edhe Brazilin, 8 për qind Shqipërinë - aq sa edhe Francën dhe 2 për qind Portugalinë.



Ndër ekipet e huaja, ndërkaq, prin Barcelona me 33 për qind, pasuar nga Real Madridi me 27 për qind. Chelsea është ekip i preferuar i 12 për qind të të anketuarve, ndërkaq Manchester United radhitet i katërti me 8 për qind e Bayern Munchen i pesti me 6 për qind. Ekipet italiane Milan, Inter, Roma e Juventus preferohen secili nga 2 për qind e të anketuarve.

Në pyetjen për lojtarin më të preferuar, 36 për qind kanë përmendur Lionel Messinë e 22 për qind Christiano Ronaldon. Mesut Ozil është i pëlqyer i 6 për qind të të anketuarve, kurse nga 4 për qind të “votave” kanë fituar Wayne Rooney, Michael Ballack, Karim Benzema, Didier Drogba e Frank Lampard. Nga 2 për qind të të anketuarve kanë thënë se të preferuarit e tyre janë Xherdan Shaqiri, Iker Casillas, Cesc Fabregas e Francesco Totti.

Pavarësisht se hulumtimi është realizuar në Prishtinë, ndër ekipet vendore më e preferuara nga të anketuarit është Besa e Pejës me 46 për qind të preferencave, pasuar nga Prishtina me 38 për qind. Vazhdojnë Drita, Trepça e Vllaznimi me nga 4 për qind etj.

Hulumtimet në terren, si ky për futbollin, janë pjesë përbërëse e rëndësishme e programeve studimore të Kolegjit “Pjetër Budi” dhe e punës praktike të studentëve.

Hulumtim: Meshkujt pëlqejnë Golf'in, femrat Mercedes'in

Veturat e tipit Golf dalin të jenë më të preferuarat për qytetarët e tri komunave të Kosovës. Ky është rezultat i një hulumtimi të realizuar në Prishtinë, Kamenicë dhe Gjakovë nga një grup studentësh të Kolegjit “Pjetër Budi”, në kuadër të punës së tyre hulumtuese-shkencore. Ky lloj veturash preferohet nga 37 për qind e të anketuarve, pasuar nga 23 për qind që pëlqejnë veturat Mercedes, 18 për qind BMW dhe 15 për qind Audi.

Të qenit “më ekonomike” e kanë radhitur si arsye të parë për preferencat e tyre ndaj veturave 39 për qind e të anketuarve, ndërkaq shpejtësinë 32 për qind.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (58 për qind) preferojnë vetura diesel, ndërkaq 39 për qind me benzinë, ndërkaq ngjyra e zezë është më e pëlqyera - 42 për qind.

Këto janë të dhënat e përgjithshme, por ndryshon puna kur bëhet fjalë për preferencat gjinore. 82 për qind e të anketuarve ishin meshkuj dhe 18 për qind femra.

Përderisa meshkujt më së shumti i pëlqejnë veturat e tipit Golf (39 për qind), pasuar nga ato Mercedes (21 për qind), femrat më shumë janë të apasionuara me veturat e tipit Mercedes (33 për qind), pasuar nga Golf e BMW (nga 22 për qind).



Sa iu përket ngjyrave, meshkujt në përgjithësi pëlqejnë më shumë veturat me ngjyrë të zezë, ndërkaq femrat ato me ngjyrë të kuqe.

Hulumtimet në terren, si ky për veturat, janë pjesë përbërëse e rëndësishme e programeve studimore të Kolegjit “Pjetër Budi” dhe e punës praktike të studentëve.



Hulumtim: Si jetojnë ashkalinjtë e Podujevës?



Përkundër vështirësive me të cilat përballen, pjesëtarët e komunitetit ashkali në Podujevë kanë marrëdhënie të mira me popullatën shumicë shqiptare.

Ky është rezultat i një hulumtimi të realizuar nga një grup studentësh të Kolegjit “Pjetër Budi”, në kuadër të punës së tyre hulumtuese. Qëllimi i hulumtimit ishte që të kuptohet kompleksiteti i problemeve të pjesëtarëve të pakicës ashkali në komunën e Podujevës.

Mbi 90 për qind e familjeve ashkali kanë më shumë se pesë anëtarë, ndërkaq gati gjysma nga ta (48 për qind) janë të pashkolluar.

Më se 40 për qind e tyre jetojnë nga ndihma sociale, ndërkaq të tjerët punojnë privatisht. Asnjëri nga ta nuk është i punësuar në ndonjë institucion publik, ndërkaq 60 për qind e atyre që punojnë nuk fitojnë më shumë se 100 euro në muaj.

Ata kanë edhe probleme të tjera. 56 për qind e të anketuarve thonë se e kanë sfidë sigurimin e një përkujdesjeje të mirë shëndetësore.

Përkundër të gjitha problemeve, shumica e ashkalive kanë marrëdhënie të mira me popullatën shumicë – shqiptarët. 82 për qind nga ta thonë se marrëdhëniet I kanë të mira, ndërkaq 18 për qind “mesatarisht të mira”.

Hulumtimet si ky në terren janë pjesë përbërëse e rëndësishme e programeve studimore të Kolegjit “Pjetër Budi” dhe e punës praktike të studentëve.

Hulumtim: Sa shpenzojnë kompanitë për marketing?

Kompanitë e mëdha në rajonin e Pejës shpenzojnë për marketing përgjysmë më shumë para se ato të mesmet. Kështu ka dalë të jetë sipas rezultateve të një hulumtimi të realizuar nga studentët e Kolegjit “Pjetër Budi”, në kuadër të punës hulumtuese-shkencore.

Qëllimi i hulumtimit ishte që të shihet se sa këto kompani shpenzojnë për marketing apo edhe sa i japin rëndësi marketingut, për të cilin kompanitë e mëdha botërore shpenzojnë miliona.

Kështu, kompanitë e mëdha shpenzojnë nga 2.5-10.5 për qind të buxhetit vjetor për marketing. 80 për qind e tyre mendojnë se marketingu ndikon “shumë” në reputacionin dhe suksesin e tyre, ndërsa 20 për qind “mesatarisht”.



Të gjitha kompanitë e shfrytëzojnë radion si medium për reklamim, ndërsa 80 për qind e tyre edhe ndonjë formë tjetër (TV, internet e gazeta).

Kompanitë e mesme shpenzojnë 0.5-5 për qind të buxhetit vjetor për marketing. Ato konsiderojnë bars se marketingu ndikon “shumë” dhe “mesatarisht” në reputacionin e tyre (nga 40 për qind), ndërsa 20 për qind konsiderojnë se marketingu ndikon pak.

Ndryshe nga kompanitë e mëdha, të mesmet janë të fokusuar më shumë në marketingun nëpërmjet internetit (100 për qind), për të vazhduar me TV, radio e gazeta.

Disa nga kompanitë më të njohura në botë shpenzojnë rreth 15 për qind të buxhetit vjetor për marketing.

Autorët e hulumtimit rekomandojnë se, duke pasur parasysh se të gjithë të anketuarit përgjegjës për marketingun nëpër kompani ishin meshkuj, shtrohet nevoja që në këtë sektor të punësohen edhe femra. Po ashtu, rekomandohet që përgjegjës për marketing të punësohen edhe të rinju në moshë, të cilët e njohin këtë lëmi. Hulumtimet në terren janë pjesë përbërëse e rëndësishme e programeve studimore të Kolegjit “Pjetër Budi” dhe e punës praktike të studentëve.



Vazhdon regjistrimi i studentëve të rinj në Kolegjin “Pjetër Budi”

Në kuadër të afatit të parë, është duke vazhduar regjistrimi i studentëve në Kolegjin “Pjetër Budi”, për vitin akademik 2013/2014.

Programet studimore – të gjitha të akredituara - në të cilat studentët mund të regjistrohen këtë vit janë: Doganë dhe Shpedicion, Sigurime, Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë, Sigurime, Administrim Biznesi, Menaxhim i Resurseve Njerëzore, Administratë Publike, Banka-Kontroll Financiar (Polici Financiare) dhe Menaxhim i Marketingut (në nivelin Bachelor), si dhe Menaxhment, Menaxhim i Turizmit e Hotelerisë, Menaxhim i Sigurimeve dhe Doganë e Shpedicion (në nivelin Master) .

“Pjetër Budi” është institucioni akademik më prestigjioz në rajon, me drejtime zhvillimore dhe unike dhe me garanci për punë dhe karrierë të suksesshme.

Studentët mund të zgjedhin të studiojnë në studime të rregullta, studime pa shkëputje nga puna dhe me korrespondencë.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim janë: diploma e shkollës së mesme, dëftesat e secilit vit të shkollës së mesme, certifikata e lindjes, fotokopja e letërnjoftimit dhe tri fotografi.

Afati i regjistrimit të studentëve të rinj në Kolegjin “Pjetër Budi” vazhdon deri më 15 tetor.

KONKURS

Kolegji "Pjetër Budi" shpall konkurs për regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2013 -2014:

STUDIME UNIVERSITARE

BACHELOR

Doganë & Shpedicion
Menaxhim i Turizmit & Hotelerisë
Administrim Biznesi
Menaxhim i Resurseve Njerëzore
Administratë Publike
Menaxhim i Marketingut
Banka - Kontroll Financiar (Polici Financiare)
Sigurime

MASTER

Doganë & Shpedicion
Menaxhment
Menaxhim i Sigurimeve
Menaxhim i Turizmit & Hotelerisë

U botua numri i ri i revistës “Studenti”



Ka dalë nga shtypi numri i ri, i dyti me radhë i revistës “Studenti”, e cila botohet nga Organizata Studentore e Kolegjit “Pjetër Budi”, Prishtinë.


Revista përmban material të larmishme, duke filluar nga oferta e “Pjetër Budit” për studentët e rinj dhe ngjarjet e organizimet e shumta të këtij institucioni të arsimit të lartë, e deri te materialet e shkruara nga studentët.

Po ashtu, në revistë janë përfshirë edhe intervista me studentët, të cilët flasin për të arriturat dhe përvojat e tyre në Kolegjin “Pjetër Budi”.

Në një shkrim të tij në revistë, dekani i Kolegjit “Pjetër Budi”, prof. dr. Nuhi Rexhepi thotë se ky institucion synon t’i sigurojë studentit një formim të mirë shkencor, teorik e praktik, jo vetëm aftësim në fushat përkatëse, por t’u japë edhe mundësi tjera të punësimit ose studimit të mëtejshëm. Ndërkaq studentja Marigona Dragusha, në një intervistë për revistën, porositi të rinjtë që, nëse kërkojnë kuadër të kualifikuar akademik, staf profesional dhe të përgatiten për të ardhmen e tyre, atëherë Kolegji “Pjetër Budi” është zgjedhja më e mirë.

Studentë praktikantë trajnohen në Kolegjin “Pjetër Budi”

Studentë të Kolegjit “Pjetër Budi” dhe të Universitetit të Prishtinës po kryejnë punë praktike në departamente të ndryshme të Kolegjit “Pjetër Budi”. Në kuadër të praktikës, studentët janë duke u trajnuar në fushën e marketingut, kontabilitetit, komunikimit masiv etj. Nëpërmjet aktiviteteve të tilla, Kolegji “Pjetër Budi” ka për qëllim që t’i aftësojë të rinjtë, në mënyrë që të jenë të gatshëm për tregun e punës, për ngritjen e kapaciteteve në kompanitë ku ata do të punësohen në të ardhmen dhe të jenë të aftë t’i përballojnë sfidat, në rrugën e tyre drejt ndërtimit të një karriere të suksesshme.



Gjithashtu, profesorët e Kolegjit “Pjetër Budi” po i ndajnë përvojat e tyre me studentët praktikantë.



Studentët e Kolegjit “Pjetër Budi” në Panairin e Turizmit “Peja 2013”

Studentë të Kolegjit “Pjetër Budi” kanë marrë pjesë në Panairin e Turizmit “Peja 2013”, gjatë fundjavës që lamë pas.

Ata kanë prezantuar ofertën për studime të Kolegjit “Pjetër Budi”, për drejtimin Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelarisë, si dhe Administrim Biznesi. Interesimi i bizneseve dhe i qytetarëve për programet studimore të kolegjit ishte jashtëzakonisht i madh.

Kolegji “Pjetër Budi” ofron studime në fushën e menaxhimit të turizmit dhe hotelarisë, në nivelet Bachelor dhe Master, por edhe në fushat e tjera deficitare, si Administrim Biznesi, Doganë e Shpedicion, Sigurime, Menagjment, etj.



Të gjitha hulumtimet e realizuara deri tash kanë treguar se tregu i punës në Kosovë është i ngopur me drejtimet e përgjithshme studimore, si ekonomik e juridik dhe se kërkesa dominante është ajo për ekspertë nga fusha e turizmit e hotelarisë, si dhe të profileve tjera deficitare zhvillimore.

Kolegji “Pjetër Budi” uron Majlinda Kelmendin



Kolegji “Pjetër Budi” uron Majlinda Kelmendin për titullin kampion bote në xhudo.

Fitorja historike e Majlinda Kelmendit na bën krenarë të gjithëve në Kosovë dhe shqiptarët kudo që janë. Ajo është ambasadorja më e mirë e shtetit të ri të Kosovës në botë.

Majlinda Kelmendi na ka entuziazmuar të gjithë ne që kemi besuar në suksesin e saj. Ajo është shembull për të gjithë se si me punë të palodhshme dhe sakrificë, rezultatet dhe sukseset nuk mungojnë.

Kolegji “Pjetër Budi” i uron suksese të mëtejme Majlinda Kelmendit.

Afaristë të njohur nga Gjermania vizituan Kolegjin “Pjetër Budi”



Në vazhden e thellimit të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare, në Kolegjin “Pjetër Budi” ishin për vizitë pune afaristë të njohur nga Gjermania.

Pronari i firmës Ma-Tax Consulting GmbH, Karl Heinz Matt, së bashku me Clemens Sexauer dhe Roman Bertram, të cilët janë pronarë të kompanisë BEO GmbH, si dhe Burim Neziri, bashkëpronar i kompanisë FAMA Sh.P.K. në Gjermani, me qëllim të zhvillimit të Programit Studimor Doganë dhe Shpedicion, ofruan mundësin që studentë nga Kolegji “Pjetër Budi” të dërgohen për studime tremujore në Gjermani, me theks të veçantë në lëmin e Doganave dhe Shpedicionit.

Udhëheqës i Programit Studimor Doganë dhe Shpedicion, prof. dr. Orhan Çeku, tha se menjëherë do të fillojnë përgatitjet për dërgimin e studentëve në vizitë studimore në Gjermani.

“Stafi i kolegjit shprehu interesimin për bashkëpunim me kompanitë të cilat përfaqësojnë mysafirët dhe ne shumë shpejt do të fillojmë përgatitjet për dërgimin e studentëve në vizitë studimore në Gjermani. Shpresojmë që në fillim të muajit tetor, studentët do të fillojnë praktikën tremujore në disa prej kompanive më prestigjioze të Gjermanisë”, theksoi Çeku.

Sondazh: A shpenzoni më shumë se 5 euro në ditë?

Në sondazhin e realizuar nga Kolegji “Pjetër Budi” nëpërmjet web faqes, në pyetjen “A shpenzoni më shumë se 5 euro në ditë”, 68.4% e respondentëve janë deklaruar se shpenzojnë më shumë, ndërsa 31.6% më pak. Sondazhi online i Kolegjit “Pjetër Budi” ka qenë i hapur për përgjigje në web faqe gjatë një muaji.

